

PROCESI I BOLONJËS – SFIDA E ARSIMIT TË LARTË SHQIPTAR

1. Procesi i Bolonjës

Studimet univeristare në Evropë janë duke iu nënshtruar një ndryshimi të rëndësishëm. Institucionet evropiane të arsimit të lartë kanë pranuar sfidën për të pasur një rol kryesor në ndërtimin e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë, nëpërmjet realizimit të procesit të Bolonjës, që numëron deri sot shtatë hapa të rëndësishëm dhe ku dokumentet më të rëndësishme janë:

1. **Magna Charta Universitatum:** “Mbi rolin që duhet të luajnë Universitetet në një shoqëri gjithnjë e më të ndërkombëtarizuar” (Bolonjë, 18 Shtator 1988).
2. **Konventa e Lisbonës:** “Për njohjen e kualifikimeve profesionale të arsimit të lartë në rajonin e Evropës” përpiluar nga KE dhe UNESCO (8 -11 Prill 1997).
3. **Deklarata e Sorbonës:** “Harmonizimi i arkitekturës së sistemit të arsimit të lartë evropian” Paris, Sorbonne, 25 Maj 1998)
4. **Deklarata e Bolonjës:** “Ndërtimi i Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë” (Bolonjë, 19 Qershor 1999).
5. **Kongresi i Salamankës:** “Formimi i Hapësirës Evropiane të Shkollimit të Lartë” Salamanka, 29 - 30 Mars 2001.
6. **Mbledhja e Ministrave Evropianë të arsimit të lartë në Pragë:** “Riafirmimi i objektivit të krijimit të fushës së arsimit të lartë evropian deri në 2010” (Pragë, 19 Maj 2001).
7. **Konferenca e Berlinit:** “Për realizimin e një Zone koherente e kohezive Evropiane të Arsimit të Lartë deri në vitin 2010” Berlin 19 Shtator 2003.
8. **Konferenca e Bergenit** (18 maj 2005) e cila i kushtoi një rëndësi të veçantë tri niveleve të studimit ku përparësi të veçantë merr sigurimi i cilësisë.

Përveç këtyre dokumenteve rëndësi ka “Deklarata Botërore mbi Shkollimin e Lartë”, e cila ka dalë nga Konferenca Botërore për shkollimin e lartë në Paris 5 – 9 tetor 1988.

Procesi i Bolonjës është produkt dhe vazhdimësi i serive të konferencave Evropiane dhe një numri vendosjesh të politikave që kanë për qëllim krijimin e HEAL deri në 2010.

Duke paraqitur **etapat kryesore të procesit të Bolonjës**, duhen përmendur së pari, pesë konferencat e Ministrave të Arsimit që janë mbajtur deri tani (në Sorbonë 1998, në Bolonjë 1999, në Pragë 2001 dhe në Berlin 2003 dhe Bergen 2005). Përveç këtyre, në Mars 2001 pati dy ngjarje të veçanta që u mbajtën para konferencës së Ministrave: një konventë akademike në Salamanka dhe një konventë studentore në Gotenborg. Të gjitha këto ngjarje u kurorëzuan me deklarata dhe komunikata politike të procesit, që përvijojnë rrugët drejt Epokës së Arsimit të Lartë Evropian.

Pra, pesë ciklet kryesore të Procesit të Bolonjës janë ato të **Paris-La Sorbonne** (25 Maj 1998), **Bologna** (19 Qershor 1999), **Prague** (19 maj 2001) dhe **Berlin** (18-19 Shtator 2003) dhe Bergen (19-20 maj 2005).

Deklaratën e Paris-La Sorbonne

Premisat për procesin e Bolonjës u krijuan në Deklaratën e Paris-La Sorbonne në **Harmonizimin e Arkitekturës të Sistemit të Arsimit të Lartë Evropian** të nënshkruar në Maj 1998 nga Ministrat e Arsimit të katër shteteve: Francë, Gjermani, Itali dhe Mbretëri e Bashkuar.

Paris - La Sorbonne përfshin tre parime:

- Lehtësimin e lëvizjes së studentëve në hapësirën evropiane dhe integrimin e tyre në tregun evropian të punës, si dhe lëvizjen e pedagogëve;
- Përmirësimin e transparencës ndërkombëtare të kurseve dhe njohjen e kualifikimeve, në kuptimin e konvergjencës graduale në drejtim të kuadrit të përbashkët të kualifikimeve dhe cikleve të studimit;
- Inkurajimi i kthimit për studimet ose vazhdimi i tyre në të njëjtin institucion ose në një institucion tjetër në të njëjtin shtet ose nëpërmjet rregullimit të lëvizjes evropiane.

Bologna, 19 Qershor 1999

Një vit më vonë (qershor 1999), u nënshkrua **Deklarata e Bolonjës për një Hapësirë Evropiane të Arsimit të Lartë**, e cila ishte inspiruar shumë nga Deklarata e Sorbonës. Përveç aspekteve që përmban ajo, një tipar i ri ishte zgjerimi i debatit, që tani kishte 29 shtete nënshkruar (15 Shtete Anëtare të BE, 3 vende të EFTA-s, Irlanda, Norvegjia dhe Zvicra, si dhe 11 vendet kandidate) dhe përfshinte institucione të tilla si Komisioni Evropian, Këshilli Evropian dhe shoqata universitetesh, rektorë dhe studentë evropianë. *Objektivat kryesore që u përcaktuan ishin:*

- ❖ Adoptimi i një sistemi të gradeve shkencore të njohura me lehtësi dhe të krahasueshme, gjithashtu përmes Plotësimit të Diplomave, me qëllim që të nxitet aftësia për punësim e qytetarëve evropianë dhe konkurenca ndërkombëtare e sistemit evropian të arsimit të lartë.
- ❖ Adaptimi i një sistemi kryesisht të bazuar në dy cikle kryesore, universitare dhe të diplomuar me grada shkencore. Përdorimi i ciklit të dytë do të kërkojë plotësimin e sukseshëm të ciklit të parë të studimeve, që zgjat në një minimum prej tre vjetësh. *Grada shkencore që jepet mbas ciklit të parë do të njihet në tregun evropian të punës si një nivel i përshtatshëm kualifikimi.* Cikli i dytë do të çojë në titullin master dhe/ose doktoratë si në shumë vende Europiane.
- ❖ Vendosja e sistemit të krediteve –te tilla si sistemi ECTS - si një mjet i përshtatshëm për nxitjen e lëvizshmërisë më të gjerë të studentëve. Kreditet gjithashtu mund të përftoheshin dhe në kontekstin e arsimit jo-të lartë, duke përfshirë të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke siguruar që ato të njihen nga universitetet e interesuara.
- ❖ Promovimi i lëvizshmërisë duke kapërcyer pengesa drejt të ushtruarit të efektshëm të lëvizjes së lirë, me vëmendje të veçantë ndaj:
 - studentëve, mundësi për studim, trainim dhe shërbime që lidhen me to,
 - për pedagogë, kërkues dhe staf administrativ, njohje e periudhave të harxhuara në konkurimet kërkimore Europiane, mësimdhënie dhe trainim, pa paragjykuar të drejtat e tyre statuore.
- ❖ Promovimi i bashkëpunimit evropian në sigurimin e cilësisë me synim zhvillimin e kriterëve dhe metodologjive krahasuese.
- ❖ Promovimi i dimensioneve të nevojshme evropiane në arsimin e lartë, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e kurrikulës, bashkëpunimit ndër-institucional, skemave të lëvizshme dhe programeve të integruara të studimit, trainimit dhe kërkimit.

Konferenca e Pragës

Në Maj 2001, u mbajt Konferenca e Pragës, e cila përfshinte të njëjtat kategori pjesëmarrësish, tani me 33 Shtete nënshkruese (pjesëtarët e rinj ishin Litenshtejn, Qipro, Kroacia dhe Turqia). Qëllimi i kësaj konference ishte të vlerësonte progresin e arritur tashmë (në mënyrë të veçantë në bazë të raporteve kombëtare) dhe identifikimi i parimeve kryesore ku duhej të drejtohej procesi i Bolonjës në vitet në vazhdim. Ndërsa konferenca e Pragës konfirmoi nevojën e vazhdimin të qëllimeve të vendosura në Deklaratën e Bolonjës, ajo megjithatë shtoi rëndësinë e tre çështjeve të veçanta.

Tre çështjet specifike të theksuara nga Konferenca e Pragës:

- Të mësuarin gjatë të gjithë jetës;
- Përfshirja e institucioneve të arsimit të lartë dhe studentëve si partnerë aktivë;
- Nevojën e rritjes së atraktivitetit (tërheqjes) së HEAL.

Konferenca e Berlinit

Në 18 - 19 Shtator 2003 ministra të arsimit dhe shkencës nga çdo vend i Evropës (përfshi Rusinë dhe Turqinë) u takuan në Berlin, për të vendosur për të ardhmen e procesit të Bolonjës, një proces që do ta transformojë arsimin e lartë në çdo vend Evropian dhe do të krijojë "Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë" në vitin 2010. Në këtë konferencë u pranua si anëtar edhe vendi ynë me nënshkrimin e marrëveshjes nga ministri Memushi. Në shumicën e vendeve, kjo thujse ka ndikuar në strukturën e përgjithshme të kualifikimeve, paraqitjen e ndryshimit të sistemit të krediteve të transferueshme me vlerësime të reja.

Në takimin më të fundit në Berlin, në Shtator 2003, 40 vende nënshkruan dokumentin, ku vendet Europiane të lëna jashtë procesit ishin vetëm Ukraina dhe Bjellorusia. Në Berlin, ministrat gjithashtu ranë dakort të zgjerojnë "sistemin me dy cikle" në "sistem me tre cikle", duke përfshirë kështu studimet e doktoraturës si cikli i tretë në procesin e Bolonjës. Ministrat përgjegjës për arsimin e lartë në Berlin rishikuan progresin e arritur, për të shpejtuar realizimin e HEAL, dhe për të vendosur prioritete dhe objektiva të reja për vitet e ardhshme, me qëllim përmirësimin e karakteristikave sociale të saj, si dhe *forcimin e kohezionit social dhe reduktimin e pabarazisë sociale dhe gjinore në nivel Evropian*. Në këtë kontekst, ministrat ripohuan qendrimin e tyre se arsimi është një e mirë publike dhe përgjegjësi publike.

Universitetet si institucione legale kanë nevojë për autonomi dhe duhet të jenë të përgjegjshëm për: planifikim strategjik, përcaktim të objektivave dhe prioriteteve; alokimin e fondeve; zgjedhjen e partnereve mbi bazë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, në punë kërkimore dhe në mësimdhënie; zgjedhja e fushave kërkimore; përcaktimi i kurrikulës; menaxhimi i kapitalit njerëzor, punësimi i profesorëve në veçanti; përcaktimi i rregullave të pranimit për studentët.

Konferenca e Bergenit

Në Bergen (19-20 maj 2005) u vlerësua niveli i deritanishëm i realizimit të objektivave të procesit të Bolonjës në dritën e objektivave të arsimit evropian deri më vitin 2010 dhe është miratuar Komunikata e Bergenit për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit të lartë në Evropë gjatë dy viteve të ardhshme deri në takimin që do të mbahet në Londër në maj 2007.

Gjatë punimeve të Konferencës janë pranuar pesë anëtarë të rinj të procesit të Bolonjës përmes nënshkrimit të Kartës së Bolonjës.

Në Konferencë është konstatuar sukcesi i arritur në vendosjen e sistemit të sigurimit të cilësisë, sistemin e niveleve të studimit, në njohjen e diplomave dhe në mobilitetin e studentëve. Këtu është rënë dakort dhe është miratuar komunikata e Bergenit e ministrave evropianë për Arsimin e Lartë dhe për periudhën 2005 - 2007 do punohet për përmirësimin e raportit ndërmjet kërkimeve shkencore dhe studimeve të doktoratës, implementimin e standardeve dhe udhëzimeve për sigurimin e cilësisë sipas raportit të ENQA-s, përmirësimin e strukturave kombëtare të kualifikimeve, dhënien dhe njohjen e diplomave të përbashkëta (përfshirë nivelin e doktorates), etj.

Hapi i nëntë ishte **Kommunikata e Londrës** (16-18 maj 2007) firmosur nga ministri i Arsimit dhe Shkencës Z. Genc Pollo. Kete Komunikate e gjeni të plotë po në këtë rubrikë.